



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr. 985/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit “Shell Brands International AG”, me seli në Baarermatte, 6340 Baar në Zvicër, të cilën e përfaqëson K. N.-Sh. avokate nga Prishtina, kundër të paditurit “EURO MITI”, NUI: ..., me seli në fshatin Prelez i Jerlive, Magjistralja Prishtinë - Shkup, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh. Sh., avokat nga Gjilani, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.568/2022, të datës 20.04.2023, me datë 12.12.2023, mori këtë;

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës “EURO MITI”, NUI: ..., me seli në fshatin Prelez i Jerlive, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.568/2022, të datës 20.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar është aprovuar në tërësi kërkesëpadiat e paditësit “Shell Brands International AG”, ashtu që është vërtetuar se i padituri “EURO MITI”, përmes përdorimit të kombinimit të ngjyrave të kuqe, të verdhë dhe të bardhë, në objektin e tij dhe në veprimtarinë e tij afariste, ka shkelur markat tregtare të paditësit të regjistruara me numrat 8838; 8837; 8835; 8726 dhe 3814. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit i është ndaluar të paditurit që në të ardhmen të përdor kombinimin e ngjyrave të kuqe, të verdhë dhe të bardhë në objektin e tij dhe në të gjitha objektet tjera ku ushtron veprimtarinë e tij afariste. Me pikën III të dispozitivit është detyruar i padituri që të i largoj shenjat si në pikën I dhe II të këtij dispozitivi, duke përfshirë por pa u kufizuar në materialet promocionale dhe korrespondencat afariste, në afat prej 7 ditësh prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Ndërkaq me pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1598.00 € (njëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 ditësh prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e paditësit si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i i gjykatës së shkallës së parë ashtu që të refuzohet si e palejuar padia e paditësit, ose çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja në përgjigje në ankesë propozon që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.568/2022, të datës 20.04.2023, si dhe të detyrohet e paditura që t'i paguaj paditësit shpenzimet për avokat edhe në lidhje me përgjigjen në ankesë në shumë prej 516 €, shtuar shpenzimeve të gjykuara në shkallë të parë në shumë prej 1598 €.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi “Shell Brands International AG” përmes të autorizuarës së tij, me datën 07.08.2020, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare kundër të paditurit “EURO MITI”, me të cilën ka kërkuar që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit “Shell Brands International AG” dhe të vërtetohet se i padituri, përmes përdorimit të kombinimit të ngjyrave kuqe/verdhë/bardh, në objektin e tij dhe në veprimtarinë e tij afariste, ka shkelur të drejtat e markave tregtare të paditësit me nr. 8838; 8837; 8835; 8726 dhe 3814, të ndalohej i padituri nga përdorimi i kombinimit të ngjyrave kuqe/verdhë/bardh në objektin e selisë dhe në të gjitha objektet tjera ku ushtron veprimtarinë e tij afariste, të largoj shenjat duke përfshirë por pa u kufizuar nga objekti i saj afarist, materialet promocionale, korrespondencën afariste dhe të tjera, të përmbahet nga përdorimi në të ardhmen i kombinimit të ngjyrave kuqe/verdhë/bardh në objektin e selisë dhe në të gjitha objektet tjera ku ushtron veprimtarinë e tij afariste, si dhe të obligohet që të i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësinë e provuar në shqyrtimin gjyqësor dhe të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar sepse kombinimi dhe aplikimi i ngjyrave të përdorura në objektin e të paditurit janë identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe të krijoj bindjen tek konsumatorët se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Më tej gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar ka konkluduar se nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se objekti i paditësit dhe i të paditurit në aspektin vizual kanë ngjashmëri ndërmjet tyre dhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit tek konsumatorët është e madhe, pasi që pamja e objektit të paditurit asocion në stacionet e derivateve të “Shell”, e regjistruar si markë tregtare nga paditësi. Po ashtu veprimtaria është e të njëjtës kategori dhe ndërmarrjet janë në konkurrencë me njëra tjetrën. Andaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se përdorimi i pamjes identike apo të modifikuar nga i padituri, në dizajn dhe forme pothuajse identike me paditësin, përmes kombinimit të ngjyrave: të verdhë, të kuqe dhe të bardhë, në objektin e shitjes së karburanteve në fshatin Prelez

i Jerlive, Komuna e Ferizajit, padyshim që shkaktojnë konfuzion të konsumatorët dhe krijojnë bindjen se e paditura shet produktet e paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësuan të paqëndrueshme pretendimet ankimore lidhur me gjendjen faktike respektivisht ndryshimet e shenjave të cilat paditësi i ka ndërmarë gjatë zhvillimit të procedurës, pasi që evitimi i shkeljes së markës tregtare nuk është me ndikim në rastin konkret për shkak se, shkelja e markës tregtare vecse ka ndodhur pa autorizimin e pronarit. Andaj, paditësi me faktin e posedimit të vërtetimit të regjistrimit të markës tregtare, si pronarë gëzon mbrojtje nga një sërë shkeljesh të parapara me nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare.

Sipas vlerësimit të Kolegjit shkeljet mund të bëhen gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën pronari është e autorizuar. Sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, i LMT-së, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët. Ne rastin konkret kemi të bëjmë me markë tregtare të regjistruar e cila ia njeh pronarit ekskluzivitetin e përdorimit për tërë territorin e Kosovës ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton si bazuar pretendimi i të paditurit për evitimin e shkeljes, për shkak se me faktin se një gjë e tillë është vërtetuar të ketë ndodhur, pronari edhe më tej ka interes juridik të vërtetojë shkeljen dhe t'i kërkojë garancitë ligjore të cilat i gëzon si pronar i markës tregtare.

Po ashtu, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të paditurit se i padituri ka bërë veprime me qëllim që kinse të përfitojë nëpërmjet shkakimit të konfuzionit, janë të paqëndrueshme, sepse në çështjet e vlerësimit të shkeljes së markave tregtare, gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e fakteve sa i përket shkeljes dhe cenimit të veprimeve të ndaluara me LMT, me qëllim të ruajtjes së të drejtave që gëzon pronari i markës tregtare. Andaj, në rastin konkret qëllimi është faktor jorelevant në të gjykuarit e çështjes nga gjykata e shkallës së parë, por ajo mund të jetë vetëm pasojë ligjore bazuar në kërkesat e pronarit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të

përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Thelbi qëndron në funksionin themelor të markës - identifikimit të origjinës së produktit apo shërbimit.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase bazuar në fotot që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se objekti i paditëses dhe të paditurës në aspektin vizual kanë ngjashmëri ndërmjet tyre dhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit tek konsumatorët është e madhe pasi që pamja në objektin e të paditurës asociojnë në stacionet e derivateve të “Shell” e regjistruar si markë tregtare nga paditësja, veprimtaria është e njëjtës kategori dhe ndërmarrjet janë në konkurrencë me njëra tjetrën. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se përdorimi i pamjes identike apo të modifikuar të paditëses në objektin e të paditurës, në dizajn dhe forme pothuajse identike shkelin markën tregtare të paditësit. Ndërsa përdorimi i kombinimit të ngjyrave të regjistruara si markë tregtare, padyshim që shkaktojnë konfuzion të konsumatorët dhe krijojnë bindjen se e paditura shet produktet e paditëses.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë.

Kolegji i vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me shpenzimet e procedurës, sa i përket kontestimit të elementit të huaj në procedurë, mirëpo vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë që në kontestet ku pala ka seli në shtetin e huaj, ky kontest konsiderohet me element të huaj dhe paditëses i takon shpërblimi sipas tarifës së OAK.

Nga sa u parashtrua e në mbështetje të dispozitës së nenit 200 të LPK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr. 985/2023, me datë 12.12.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova